L I G J

Nr.7881, datë 1.12.1994

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7508, DATË 7.8.1991 "PËR POLICINË USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991"Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7508, datë 7.8.1991 "Për policinë ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", në nenin 1, në fund fjalët "që kryejnë vepra penale ushtarake" ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët "që kryejnë vepra kriminale në ushtri".

Neni 2

Në nenin 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
"Për ndjekjen e veprimtarisë kriminale në radhët e ushtrisë organizohet dega e policisë kriminale ushtarake, si organ i specializuar në policinë ushtarake, me po ato të drejta që parashikohen në ligjin nr.7549, datë 14.1.1992 "Për metodat e punës të policisë kriminale në Ministrinë e Rendit Publik".

Neni 3

Ministri i Mbrojtjes nxjerr udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.976, datë 9.12.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.